



Pyetje dhe përgjigje

Konkurs për raportin më të mirë të mediave për integrimin europian në Serbinë juglindore dhe jugperëndimore

Në mënyrë që procedura e aplikimit në [Konkurs për raportin më të mirë për integrimin europian në Serbinë juglindore dhe jugperëndimore](#) të jetë e sqaruar në mënyrë të plotë, në vazhdim gjendet lista e përgjigjeve të pyetjeve që bëhen më së shpeshti. Mediet e interesuara mund të na kontaktojnë përmes adresës elektronike rspc.ep.comms@unops.org për të gjitha pyetjet shtesë dhe sqarimet.

I

P: Propozimet e konkursit nuk përmendin se në cilën gjuhë duhet të jetë raporti mediatik. Nëse raporti është në gjuhën shqipe, rome apo bullgare a do të zvoglojë kualitetin gjatë përkthimit në serbisht dhe ashtu të ndikojë në vlerësimin e raportit ?

P: PROGRES-i European ka angazhuar përkthyes për gjuhën shqipe dhe rome, e nëse do të jetë e nevojshme do të angazhojë përkthyes edhe për gjuhën bullgare, ndërsa raportet mediatike do të vlerësohen mbi kriteret e gazetarisë, vlefshmërinë dhe rëndësinë e informacionit dhe paraqitjen e tyre.

II

P: Shtëpitë mediatike llogaritë e të cilave kanë qenë të bllokuar për pak ditë a kanë të drejtë të konkurojnë ?

P: Në bazë të propozimeve të garimit, shtëpitë mediatike llogaritë e të cilave kanë qenë të bllokuara gjatë vitit të kaluar (prej 1. mars 2016 – 1. mars 2017.) nuk kanë të drejtë të konkurojnë në garim.

III

P: Nëse një apo më shumë dokumente mungojnë në dokumentacionin e konkursit, a është e mundur që të dorëzohen më vonë? Nëse po, cilat dokumente është e mundur që të dorëzohen më vonë dhe në çfarë mënyre?

P: I gjithë dokumentacioni i listuar në propozimet e Konkursit duhet të dërgohet së bashku me raportin mediatik me të cilin garojnë. Nëse mungon ndonjë dokument, ose ekziston ndonjë lëshim i qartë administrativ në aplikim, ekipi i Vlerësimit mund të kërkojë sqarime nga kandidati.

Programi finansohet nga Unioni Europian , Qeveria Zvicerane dhe Serbe dhe implementohet nga UNOPS në bashkëpunim me 34 bashkëqeverisjet lokale në juglindje dhe jugperëndim të Serbisë

www.europeanprogres.org

Dokumentet që mund të dërgohen më vonë janë ato që nuk janë lëshuar ose nënshkruar veçanërisht për nevojat e këtij Konkursi. Ekipi vlerësues ka të drejtë që të refuzojë aplikacionet e pa plotësuar, për të shmangur mundësinë që raportet kualitative mediatike të refuzohen, kandidatët duhet të përpjekin që të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

IV

P: A duhet që paisja kompjuterike audio, audio dhe video të jetë e prodhuar në vendet që janë anëtare të Bashkimit europian (BE), duke pasur parasysh se BE është donatori më i madh i programit, çka mund të paraqesë faktori kufizues sepse sasia më e madhe e këtyre paisjeve e kualitetit të lartë prodhohet jashtë BE?

P: Sipas rregullave të prokurimit të UNOPS-it nuk është e lejuar që në bazë të origjinës së mallit të ngushtojë konkurrencën e mundshme.

V

P: A duhet që të përfshihet në PDV vlera e paisjes?

P: Vlera e deklaruar e paisjes duhet të jepet në shumën neto (pa PDV).

VI

P: A duhet që organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të dorëzojnë vërtetim nga administrata tatimore dhe qeverisja lokale se i kanë paguar të gjitha obligimet tatimore deri në ditën e publikimit të thirrjes publike?

P: Nëse personi juridik i cili paraqitet në garim nuk është në gjendje që të marrë dokumentin (et)e kërkuar, mund të dorëzojë një dokument ekuivalent ose një deklaratë me arsyetim.

VII

P: A munden mediat të konkurojnë në më shumë se një raport mediatik? A duhet që ti dërgojnë ndarazi, dhe secilën herë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm?

P: Çdo aplikim, respektivisht raport, duhet të paraqitet veçmas në përputhje me kërkesat e përcaktuara në propozimet e garimit.

VIII

P: A munden OSHC ose shtëpitë mediatike të cilat nuk janë të regjistruara si medie në Regjistrin e mediave, Agjensionin për regjistrimin e bizneseve të aplikojnë në garim?

P: Në bazë të propozimeve të Konkursit në Konkurs mund të aplikojnë mediat të cilat janë të regjistruara në Regjistrin e mediave, Agjensionin për regjistrimin e bizneseve, të cilat paraqesin bazë elektronike të vetme, të centralizuar të dhënave të mediave.

IX

P: A është e mundur që mediat jashtë zonës së përgjegjësisë (ZP) të PROGRES-it European të përgatisin dhe të publikojnë raporte në lidhje me ndodhitë në disa komuna të programit në periudhën prej datës kur konkursi është i shpallur deri në mars të vitit 2017. dhe në këtë mënyrë të fitojnë të drejtën për të marrë pjesë?

P: Mediat Regjionale të cilat gjenden jashtë zonës së përgjegjësisë (ZP) të PROGRES-it European duhet që më së paku të dorëzojnë pesë raporte elektronike / raporte të lajmeve në CD (për stacione Televizive TV, radio stacione, dhe ndodhitë në më së paku pesë vetëqeverisjet lokale të përfshira në program në dy vitet e kaluara. Kështu që publikimi i raporteve të mediave më vonë, pas publikimit të konkursit, nuk i kualifikon mediat për pjesëmarrje në Konkurs.

X

P: A duhet që shtëpia mediatike dhe gazetari/ja duhet që të konkurojnë së bashku?

P:Në bazë të propozimeve të Konkursit vetëm shtëpitë mediatike mund të konkurojnë. Gazetari/ja duhet të ketë një lloj kontrate të punësimit me të dhënat e shtëpisë mediatike në përputhje me ligjet në fuqi. UNOPS-i dhe PROGRES-i European lanë të drejtë të kërkojnë kopjen e kontratës të lartpërmendur të dhënë nga shtëpia mediatike, përkatësisht gazetari/gazetarja.